

VENDIM
Nr. 360, datë 30.12.2022

MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË FILLUAR ME VENDIMIN E ERE-s
NR. 112, DATË 19.5.2022, MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “HEC - I TËRVOLIT”
SHPK, “PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJES NDËRMJET SHOQËRISË
FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË (FTL) SHA DHE SHOQËRISË ‘HEC - I
TËRVOLIT’ SHPK”

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 20, geramat “a” dhe “ë”, nenit 24, pikat 1, 2, 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 23, pika 12, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 3.9.2016; “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016; dhe “Kontratës për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.) dhe prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 101, datë 23.6.2016, të ndryshuar; vendimit të Bordit të ERE-s nr. 112, datë 19.5.2022, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘HEC - i Tërvolit’ sh.p.k. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) sh.a. dhe shoqërisë ‘HEC - i Tërvolit sh.p.k.’”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës me nr. 2129/2 prot., datë 29.12.2022,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 112, datë 19.5.2022, mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “HEC - i Tërvolit” sh.p.k., duke vendosur:

1. Pranimin për shqyrtim nga ERE të kërkesës së paraqitur nga shoqëria “HEC - i Tërvolit” sh.p.k., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërisë “HEC - i Tërvolit” sh.p.k. dhe shoqërisë FTL sh.a., duke filluar procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016.

- Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 650, datë 10.10.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 584, datë 8.10.2021, të Këshillit të Ministrave, Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, të ndryshuar, ndër të tjera vendosi:

1. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Vendosjen e detyrimit të shërbimit publik ndaj prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike, që kanë kontratë me shoqërinë Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a. Këtyre prodhuesve me përparësi u vendoset detyrimi i shërbimit publik për shitjen e energjisë elektrike të shoqëria Furnizuesi i Tregut të Lirë, në përputhje me çmimin e përcaktuar nga Enti Rregullator i Energjisë, në bazë të metodologjisë së miratuar me vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, të ndryshuar, gjatë periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, dhe ...

2. Në pikën 5, fjalët 31 dhjetor 2022, “zëvendësohen me 30 qershor 2023”.

- Sikurse evidentohet më sipër është vendosur detyrimi i shërbimit publik ndaj prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike, që kanë kontratë me shoqërinë Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a., dhe në pikën 2 është përcaktuar vijimi i gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, deri në datën 30 qershor 2023.

- Meqenëse “HEC - i Tërvolit” sh.p.k. ka nënshkruar me shoqërinë FTL sh.a., kontratën për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a., dhe prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 101, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s, të ndryshuar bazuar në VKM-në nr. 650, datë 10.10.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 584, datë 8.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, të ndryshuar, aplikohet vendosja e detyrimit të shërbimit publik ndaj prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike, që kanë kontratë me shoqërinë Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a.

- Këtyre prodhuesve përshirë dhe shoqërinë “HEC - i Tërvolit” sh.p.k., i vendoset detyrimi i shërbimit publik për shitjen e energjisë elektrike te shoqëria Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a., në përputhje me çmimin e përcaktuar nga Enti Rregullator i Energjisë, në bazë të metodologjisë së miratuar me vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, të ndryshuar, gjatë periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, e cila zgjat deri më 30 qershor 2023.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës së filluar me vendimin e Bordit të ERE nr. 112 , datë 19.5.2022, kërkesën e shoqërisë “HEC - i Tërvolit” sh.p.k., është shprehur “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) sh.a. dhe Shoqërisë “HEC - i Tërvolit” sh.p.k.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti